VENDIM
Nr. 837, datë 26.12.2024

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË DURRËS, KAMZË, MIRDITË, SHIJAK, KRUJË DHE VORË

(Ndryshuar me Vendimin nr. 816, datë 30.12.2025)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97, datë 7.12.2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 1 421 144 250 (një miliard e katërqind e njëzet e një milionë e njëqind e dyzet e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, në bazë të aktekspertizave të thelluara, në bashkitë Durrës, Kamzë, Mirditë, Shijak, Krujë dhe Vorë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Durrës, në masën 341 609 690 (treqind e dyzet e një milionë e gjashtëqind e nëntë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH;

b) Bashkisë Kamzë, në masën 173 720 000 (njëqind e shtatëdhjetë e tre milionë e shtatëqind e njëzet mijë) lekë pa TVSH;

c) Bashkisë Mirditë, në masën 126 653 347 (njëqind e njëzet e gjashtë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e treqind e dyzet e shtatë) lekë pa TVSH;

ç) Bashkisë Shijak, në masën 116 705 361 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e pesë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një) lekë pa TVSH;

d) Bashkisë Krujë, në masën 310 460 416 (treqind e dhjetë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH;

dh) Bashkisë Vorë, në masën 351 995 436 (treqind e pesëdhjetë e një milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2024, nga bashkitë Durrës, Kamzë, Mirditë, Shijak, Krujë dhe Vorë, në masën 919 202 014,60 (nëntëqind e nëntëmbëdhjetë milionë e dyqind e dy mijë e katërmbëdhjetë presje gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, në bazë të aktekspertizave të thelluara, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Durrës i transferohet fondi, në masën 204 965 814 (dyqind e katër milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e katërmbëdhjetë) lekë pa TVSH;

b) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi, në masën 173 720 000 (njëqind e shtatëdhjetë e tre milionë e shtatëqind e njëzet mijë) lekë pa TVSH;

c) Bashkisë Mirditë i transferohet fondi, në masën 126 653 347 (njëqind e njëzet e gjashtë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e treqind e dyzet e shtatë) lekë pa TVSH;

ç) Bashkisë Shijak i transferohet fondi, në masën 70 023 216,60 (shtatëdhjetë milionë e njëzet e tre mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë presje gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH;

d) Bashkisë Krujë i transferohet fondi, në masën 132 642 375 (njëqind e tridhjetë e dy milionë e gjashtëqind e dyzet e dy mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH;

dh) Bashkisë Vorë i transferohet fondi, në masën 211 197 262 (dyqind e njëmbëdhjetë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2025, nga bashkitë Durrës, Shijak, Krujë dhe Vorë, në masën 501 942 235 (pesëqind e një milionë e nëntëqind e dyzet e dy mijë e dyqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, në bazë të aktekspertizave të thelluara, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Durrës i transferohet fondi, në masën 136 643 876 (njëqind e tridhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e dyzet e tre mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH;

b) Bashkisë Shijak i transferohet fondi, në masën 46 682 144 (dyzet e gjashtë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e njëqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH;

c) Bashkisë Krujë i transferohet fondi, në masën 177 818 041 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyzet e një) lekë pa TVSH;

ç) Bashkisë Vorë i transferohet fondi, në masën 140 798 174 (njëqind e dyzet milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

3. Efekti financiar, për vitin 2024, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, dhe i transferohet bashkive Durrës, Kamzë, Mirditë, Shijak, Krujë dhe Vorë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3/1. Efekti financiar, për vitin 2025, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2025, dhe i transferohet bashkive Durrës, Shijak, Krujë dhe Vorë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe bashkitë Durrës, Kamzë, Mirditë, Shijak, Krujë dhe Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 816, datë 30.12.2025

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 837, DATË 26.12.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË DURRËS, KAMZË, MIRDITË, SHIJAK, KRUJË DHE VORË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 837, datë 26.12.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Durrës, Kamzë, Mirditë, Shijak, Krujë dhe Vorë", bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2025, nga bashkitë Durrës, Shijak, Krujë dhe Vorë, në masën 501 942 235 (pesëqind e një milionë e nëntëqind e dyzet e dy mijë e dyqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, në bazë të aktekspertizave të thelluara, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Durrës i transferohet fondi, në masën 136 643 876 (njëqind e tridhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e dyzet e tre mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH;

b) Bashkisë Shijak i transferohet fondi, në masën 46 682 144 (dyzet e gjashtë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e njëqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH;

c) Bashkisë Krujë i transferohet fondi, në masën 177 818 041 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyzet e një) lekë pa TVSH;

ç) Bashkisë Vorë i transferohet fondi, në masën 140 798 174 (njëqind e dyzet milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.".

2. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

"3/1. Efekti financiar, për vitin 2025, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2025, dhe i transferohet bashkive Durrës, Shijak, Krujë dhe Vorë në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

II. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe bashkitë Durrës, Shijak, Krujë dhe Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

masa për zvogëlimine riskut nga katastrofat në strategjinë e rikuperimit nga tërmeti, e cila përfshin gjithashtu edhe masat kryesore strukturuese kombëtare[39].

Gjetje
14. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit nuk ka hartuar dhe propozuar Këshillit të Ministrave, masat që duhet të merren në kuadër të programeve të procesit të rindërtimit dhe buxhetet e përafërta në referencë të Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" Neni 14, pika 5, gërma "e".

Konkluzion
12. Mungesa e hartimit të një dokumenti planifikimi të fondeve që do të përdoren për procesin e rindërtimit, nuk premton efikasitetin e përdorimit të tyre.

Rekomandim
14.1. KSHR të hartojë dhe propozojë në Këshillin e Ministrave, masat që duhet të merren në kuadër të programeve të procesit të rindërtimit dhe buxhetet e përafërtanë përputhje me me Aktin Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019," Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" Neni 14, pika 5, gërma "e",

Deri në Prill2022

Planifikimi i fondit të rindërtimit
Procesi i planifikimit të buxhetit të rindërtimit për vitet 2020 dhe 2021, nuk ka qenë i qartë për grupin e auditimit. Nga përgjigjet e pyetësorëve gjatë fazës së terrenit lidhur me mënyrën si planifikohet fondi i rindërtimit për vitin pasardhës dhe cila është struktura e cila kryen planifikimin, MFE ka orientuar grupin e auditimit për këtë informacion ti referohet MSHR, ndërkohë që MSHR shprehet: "*logjika e planifikimi nuk është njësoj si në situata normale, pasi jemi përpara një fatkeqësie natyrore e cila ka një proces funksionimi ndryshe*", pa sqaruar rolin që MSHR ka në këtë proces. Vihet re një mungesë bashkëpunimi dhe koordinimi mes dy subjekteve të sipërpërmendura sa i takon përgjegjësive që kanë. Gjithashtu është evidentuar se nuk ka një bazë ligjore e cila të përcaktojë qartë rolet dhe përgjegjësitë e strukturave në planifikimin e fondit të rindërtimit, mbledhjen e kërkesave për fonde, prioritizimin e sektorëve, buxhetet përkatëse etj. Nga sa është evidentuar gjatë auditimit, autoritetet përgjegjëse përfshirë Njësitë Zbatuese apo NJVQV paraqitin pranë Komisionit Shtetëror për Rindërtim, kërkesat e tyre për miratimin dhe zbatimin e programeve të rindërtimit, bazuar në problematikat dhe/ose nevojat e evidentuara në territoret e prekura nga fatkeqësia natyrore me qëllim rehabilitimin, rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja për individët dhe familjet, që kanë humbur një ose më shumë anëtarë të familjes dhe/ose kanë pësuar dëme në banesat e tyre dhe kanë mbetur të pastrehë, institucionet publike që kanë pësuar dëme në ndërtesat apo infrastrukturën publike në pronësi apo në administrim të tyre. Pra çdo kërkesë për fonde trajtohet rast pas rasti nga KSHR, po në të njëjtën mënyrë kryhet edhe shpërndarja e fondeve, rast pas rasti me vendimmarrjen e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit dhe më tej me Vendimmarrje në Këshillin e Ministrave, ku përcaktohet objekti, fondi dhe njësia zbatuese që do jetë përfituese.

Gjetje
15. Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministri i Shtetit për Rindërtim nuk janë koordinuar midis tyre me qëllim përgatitjen e projekt buxhetit të fondit të rindërtimit. Nuk del qartë cila është struktura që përgatit këtë dokument dhe bazuar mbi çfarë. Gjithashtu nuk ka patur evidencë në lidhje me planifikimin afatgjatë ose afatmesëm të fondit të rindërtimit. Mungesa e planifikimit

[39] Progres Raporti BE për Shqipërinë 2020

afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të fondeve që do të përdoren për rindërtimin nukkrijon mundësi për prioritizimin e sektorëve ku do ndërhyet, investime të gabuara dhe përdorim jo eficient të fondeve.

Konkluzion
13. Si në çdo rast tjetër përgatitja e projekt buxhetit kryhet nga MFE bazuar në kërkesat për fonde rindërtimi të planifikuara për t'u alokuar gjatë vitit pasardhës sipas programeve të rindërtimit. Mungesa e planifikimit të fondeve që do të përdoren gjatë procesit të rindërtimit, si në rastin e planifikimit afatshkurtër, afatmesëm apo afatgjatë krijon mundësi për përdorim jo eficient të tyre.

Rekomandim
15.1 Ministria e Financave dhe Ekonomisënë bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Rindërtim, të nisë procesin e planifikimit afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të fondit të rindërtimit bazuar në kërkësat e grumbulluara dhe prioritizimin e programeve të rindërtimit, me qëllim përdorimin eficient të fondeve.

Deri në prill 2022

Mënyra e përdorimit të Fondit të Rindërtimit
Ligji nr.88/2019 "Për Buxhetin e vitit 2020" i ndryshuar, përcaktoi Fondin e Rindërtimit në masën 32 miliardë lekë në nivel total vjetor, ndërkohë që Neni 7 përcakton përdorimin i tij si më poshtë:
"Fondi i Rindërtimit prej 32 miliardë lekë, i cili përdoret për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019, përbëhet nga:

- Grante 3 miliardë lekë
- Shpenzime të buxhetit të shtetit 29 miliardë lekë

Në zbatim të Ligjit "Për buxhetin e vitit 2020", te ndryshuar, dhe përcaktimeve për Fondin e Rindërtimit si më sipër, në Udhëzimin Plotësues nr.2, datë 20.01.2020, në paragrafin 27 është përcaktuar se"Fondi i Rindërtimit do të përdoret për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019.Mënyra e përdorimit të Fondit të Rindërtimit, programet buxhetore ku do të alokohet fondi si dhe institucionet dhe agjencitë, zbatuese të tij, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave. Në fund të vitit buxhetor, fondet e pashpenzuara trashëgohen në vitin pasardhës dhe do të përdoren për të njëjtin qëllim."
Me Ligjin e buxhetit nr. 137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021", te ndryshuar, në nenin 7 të tij është përcaktuar se "Fondi i rindërtimit për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019 prej 28 miliardë lekësh përdoret për të përballuar kostot për projektet e miratuara dhe të pafinancuara në vitin 2020, si dhe për projektet e reja. Me qëllim evidentimin e saktë të shpenzimeve për rindërtimin, raportimi i përdorimit të këtyre fondeve është bërë në përputhje dhe sipas përcaktimeve në shkresën e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 23038, datë 10.12.2020 "Sistemim i fondit të rindërtimit të pasojave të tërmetit të datës 26 Nëntor 2019 sipas kodeve të produkteve specifike". Sipas kësaj shkrese të gjitha fondet e akorduara për rindërtimin do të pajisen me kode produkti specifike vetem për rindërtimin, duke mundësuar në këtë mënyrë edhe gjenerimin e raporteve të këtyre të dhënave nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë. Raportimi i shpenzimeve faktike për rindërtimin bëhet si zë më vete në raportimin e Treguesve Fiskalë të Buxhetit të Konsoliduar, si periodike ashtu edhe vjetore.

Nga analiza e përgjigjeve të pyetësorëve të fazës së terrenit rezultoi se MSHR dhe MFE nuk disponojnë të dhëna për fondet totale të alokuara ndarë sipas programeve të rindërtimit. Ndërsa Bashkia Tiranë dhe Bashkia Durrës kanë raportuar të dhëna si më poshtë:

Bashkia Tiranë
Fondet e alokuara dhe përdorurapër Bashkinë Tiranë, ndarë sipas programeve të rindërtimit janë si më poshtë:

e njëjta situatë me vitin 2022, gjë që tregon se normalisht nuk duhet të ketë patur fatura të prapambetura për likuidim nga vitet e mëparshme. Për 9 mujorin janar-shtator janë realizuar 31 % investimit vjetor, 7 % më ulët se shpenzimet kapitale, ndërsa në dhjetor janë shpenzuar 64 % e shpenzimeve vjetore gjithsej, duke mos ruajtur shpërndarjen e tyre në mënyrë të balancuar dhe në përputhje me objektivat strategjikë.

Fondi i shpenzuar për rindërtimin përbën 13.6 % të investimeve, 2.4 % të shpenzimeve gjithsej, si dhe 0.7 % të PBB.

Fondi i shpenzuar për rindërtimin është realizuar 12,673 milion lekë më pak se në vitin 2022 dhe akoma nuk ka përfunduar, edhe pse ka pasur synim përfundimin e tij brenda gjysmës së parë të vitit 2023[6].

Nga auditimi në MF konstatohet se, në vlerën e raportuar te tabela e treguesve fiskalë janë përfshirë edhe shpenzimet për rindërtimin që janë realizuar nga të ardhurat e veta të institucioneve, në vlerën totale 73.7 milion lekë, nga të cilat 29 milion lekë nga të ardhurat e veta të njësive të qeverisjes vendore dhe 44.7 milion lekë nga të ardhurat e veta të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Veç kësaj, në investimet për rindërtimin në vlerën e realizuar nga qeverisja vendore janë përfshirë dhe 20 % shpenzime operative dhe transferta të tretëve. Pra, rezulton se MF ka mbivlerësuar në raportim shpenzimet kapitale për rindërtimin për pjesën e të ardhurave të përdoruar nga burimet e veta të institucioneve dhe shpenzime të tjera operative të njësive vendore për këtë qëllim.

Referuar VKM-vë të dala për rindërtimin, gjatë periudhës 2020-2023, konstatohet se janë miratuar 120,726 milion lekë projekte rindërtimi për qeverisjen qendrore dhe vendore dhe janë realizuar sipas raportimeve të MF deri më 31.12.2023 financime në vlerën gjithsej prej 91,298 milion lekë, gjë që do të thotë që, financimi i pritshëm për periudhat e ardhshme (viti 2024 e në vijim) mbetet rreth 29,428 milion lekë. Ndërkohë në ligjin nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", fondet për rindërtimin janë planifikuar në vlerën 7,000 milion lekë dhe për vitin 2025 është 0 lekë. Pra, rezulton se, kosto totale e projekteve të deritanishme të miratuar me VKM, nuk është mbuluar me planifikimin e fondeve buxhetore të nevojshme për rindërtimin në vitet ardhshme është rreth 22,428 milion lekë.

Mos përfundimi i procesit të rindërtimit, sjell kosto shtesë për buxhetin e shtetit edhe si rezultat i subvencionimit të qirave për familjet që banesat e tyre janë ende në proces rindërtimi, që sipas kërkesave të muajit shkurt 2023 të bashkive të dëmtuara nga tërmeti janë 8,528 familje që e përfitojnë këtë bonus. Referuar bazës së të dhënave buxhetore për vitin 2023, janë alokuar 500 milion lekë për subvencionimin e qirave dhe janë realizuar 496 milion lekë, nga të cilat rreth 1 milion lekë janë detyrime të prapambetura. Theksojmë se, Ministria e Financave ka ndërprerë financimin e subvencionimit të qirasë nga buxhetit i shtetit që nga muaji prill 2023, duke ja kaluar këtë shpenzim për financim buxhetit të bashkive.

Duhet theksuar se fondi i rindërtimit ka një rëndësi të dyfishtë pasi, përveç se vijon të mbetet një çështje emergjente që kërkon menaxhim efektiv në kohë, ka një peshë të konsiderueshme në buxhetin e shtetit. Ndryshimet e shpeshta dhe të konsiderueshme të fondit të rindërtimit në vite

[6] https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2021/12/Buxheti-per-Qytetaret-2022.pdf

dhe mungesa e mbulimit me fonde buxhetore e projekteve të miratuara evidentojnë problematika në planifikimin dhe menaxhimin e procesit të rindërtimit, duke mos pasur objektiva të qarta dhe monitorim të ecurisë së këtij procesi, me pasoja në humbjen e trajtimit emergjent në këtë rast.

3. Fondi rezervë dhe kontigjenca

Fondi rezervë, ashtu si edhe shume tregues të tjerë, ka pësuar ndryshime në planifikim në rritje 15 % nga ligji vjetor i buxhetit 2023 me akte normative të mëvonshme.

Sipas Raportit të MF "Mbi përdorimin e fondeve rezervë të buxhetit të shtetit dhe kontigjencave gjatë periudhës 1 janar - 31 dhjetor 2023", dhe aneksit "ç" që shoqëron këtë raport, fondi rezervë ka qenë planifikuar 4,000 milion lekë dhe është realizuar 3,974 milion lekë sipas vendimeve të KM, ose kanë mbetur pa u shpenzuar 26 milion lekë për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, pasi 1,800 milion lekë të destinuara për përballimin e kostos së zgjedhjeve për organizimin e zgjedhjeve për organet e vetëqeverisjes vendore janë akorduar plotësisht me VKM nr.38 datë 07.01.2023.
Planifikimi dhe realizimi i fondit rezervë dhe kontigjencës sipas Raportit të mësipërm jepet në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.10 Planifikimi dhe realizimi i përdorimit të fondit rezervë dhe kontigjencës 2023

Në milion lekë

Neni	Emërtimi	Ligji i buxhetit	AN nr.5	AN nr.6	Realizimi	Diferenca
11	**Fondi rezerve dhe kontigjenca**	**15,500**	**17,200**	**18,980**	**18,943**	**(37)**
14	a) Fondi rezerve	3,500	3,800	4,000	3,974	(26)
	Njësitë e qeverisjes së përgjithshme	*1,700*	*2,000*	*2,200*	*2,174*	(26)
	Përballimi i kostos së zgjedhjeve	*1,800*	*1,800*	*1,800*	*1,800*	-
	b) Kontigjenca	12,000	13,400	14,980	14,969	(11)

Burimi: Të dhëna të MF të përpunuara nga KLSH

Duhet theksuar se, referuar tabelës "Treguesit fiskal sipas buxhetit të konsoliduar 2023" që shoqëron Raportin "Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2023" të Ministrisë së Financave, këta tregues raportohen me realizim 100 %, pra me diferenca në krahasim me situatën faktike të përdorimit të burimit të këtyre shpenzimeve.

Në vitin 2023, nga 18,890 milion lekë të programuara për t'u shpenzuar nga fondi rezervë dhe kontigjenca, janë akorduar 18,943 milion lekë, me fonde të mbetura prej 37 milion lekë. Janë përdorur 1,689 milion lekë fonde më pak krahasuar me vitin 2022.

Nga auditimi në MF ka rezultuar se, ndërsa në nenin 11 të ligjit të buxhetit vjetor 2023 është parashikuar fondi rezervë dhe kontigjenca, si dhe kontingjencë për risqet e borxhit, në një kohë që Ligji Organik i Buxhetit ka përcaktuar që fondi i kontingjencës krijohet për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave dhe efektet e paparashikuara të normave të interesit[7]. Fakti që të ardhurat kanë ndryshuar në rritje me AN nr.5 dhe janë realizuar 101.6 % në krahasim me ligjin vjetor të buxhetit tregon se nuk ka lindur nevoja e përdorimit të këtij fondi.

[7] Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 5

Tabela nr. 7: *Realizimi faktik i fondeve të Programit të Rindërtimit sipas bashkive (në mijë lekë)*

NJVQV	Plani	Fakti 6 mujor	Realizimi
Bashkia Tiranë	1,857,523	84,894	5%
Bashkia Durrës	1,034,491	15,100	1%
Bashkia Shijak	351,759	88,252	25%
Bashkia Kavajë	214,735	14,510	7%
Bashkia Rogozhinë	246,189	16,055	7%
Bashkia Krujë	717,745	192,358	27%
Bashkia Kurbin	680,946	332,489	49%
Bashkia Lezhë	95,425	8,465	9%
Bashkia Mirditë	92,537	895	1%
Bashkia Vorë	228,503	47,789	21%
Bashkia Kamëz	343,292	13,675	4%
Total	**5,863,143**	**814,481**	**14%**

Burimi: *Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2026)*

3. Fondi i rindërtimit

Fondi i rindërtimit vijon të përbëjë një burim të rëndësishëm financimi për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Për 8 mujorin 2026, buxheti i disponueshëm për këtë fond rezulton në **6.6 miliard lekë**, ndërsa realizimi faktik ka arritur në **977 milion lekë**, ose rreth **14.8%** të fondit të programuar.

Nga realizimi total, 285 milion lekë janë përdorur për shpenzime kapitale, 8 milion lekë për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, ndërsa 684 milion lekë janë përdorur në formën e transfertave për familjet dhe individët përfitues. Struktura e realizimit tregon se pjesa më e madhe e fondeve të përdorura deri në këtë periudhë është orientuar drejt mbështetjes së familjeve dhe individëve të prekur, ndërkohë që pjesa e investimeve pritet të intensifikohet gjatë pjesës së mbetur të vitit.

Njëkohësisht, vihet re se ritmi i realizimit të fondit mbetet relativisht i ulët krahasuar me fondin e disponueshëm, megjithatë ekziston potenciali për përshpejtim të zbatimit të projekteve të rindërtimit gjatë muajve në vijim rritje të realizimit të shpenzimeve nga ky fond.

Tabela 26: **Detajimi i fondit të rindërtimit sipas llojit të shpenzimeve** ***(në milion lekë)***


Nr	EMËRTIMI	8 mujori 2026	
		Buxheti operativ	Realizimi faktik
III.	**Fondi i Rindërtimit**	**6,617**	**977**
	Shpenzime kapitale	2,693	285
	Shpenzime Operative & Mirëmbajtje	470	8
	Transferta për familjet dhe individët	3,454	684

Burimi: Ministria e Financave, SIFQ, https://financa.gov.al/realizimi-accrual_cash/

9.5 ECURIA E BORXHIT PUBLIK PËR PERIUDHËN JANAR-SHTATOR 2026

Në fund të muajit qershor 2026, borxhi publik u vlerësua në nivelin 1,367.9 miliard Lekë ose 49.0%[8] e PBB-së, duke u ulur me 3.9 p.p krahasuar me fundin e vitit 2025. Në vijim, raporti i borxhit ndaj PBB-së do të vazhdojë të planifikohet më i ulët se niveli i vitit të kaluar, derisa niveli i borxhit të arrijë dhe të qëndrojë nën 45% të PBB-së, kjo në përputhje me parimin përkatës fiskal të përcaktuar në kuadrin ligjor.

Figura 25: ***Borxhi publik në vlerë absolute dhe relative ndaj PBB (2020- Qershor 2026)***



Burimi: *Ministria e Financave (2026)*

Përbërja e Borxhit Shtetëror

Sa i përket strukturës së maturimit, në portofolin e borxhit të brendshëm shtetëror, referuar të dhënave të gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, peshën më të madhe e mbajnë titujt afatmesëm (2-5 vite) me 41.1% të peshës. Në përputhje me objektivin strategjik për rritjen e jetëgjatësisë së portofolit të borxhit të brendshëm, pesha e titujve me afat të gjatë maturimi (mbi 5 vite) është rritur me 3.8 pp, dhe pesha e titujve afatshkurtër është ulur me 2.3 pp krahasuar me fundit e vitit 2025. Ndërkohë, pesha e titujve me norma interesi të ndryshueshme mbetet në nivele të ulëta (nën nivelin prej 0.5%), pasi edhe gjatë kësaj periudhe nuk ka patur emetime të titujve me norma interesi të ndryshueshme, në përputhje me objektivat për reduktimin e riskut të normave të interesit dhe shmangien e fragmentimit të kërkesës për titujt me maturitet të ngjashëm.

Figura 26: ***Kompozimi i borxhit të brendshëm shtetëror sipas maturitetit të titujve dhe tipit të interesit (2020–Qershor 2026)***

[8] *PBB për vitet 2020-2025: Burimi- Instat (http://databaza.instat.gov.al). Parashikimi 2026 , Burimi -Drejtoria Makroekonomike dhe Statistikave pranë MF https://financa.gov.al/kuadri-makroekonomik-dhe-fiskal (VKM Nr.516 datë 30.06.2026)*

duhet të rindërtoheshin, 83 745 njësi të tjera banimi u dëmtuan pjesërisht ose lehtë me nevoja për riparim.

Në kushtet e emergjencës dhe menjëherë pas ngjarjes qeveria shqiptare u angazhua tërësisht përmes mekanizmit të fondit rezervë të buxhetit të shtetit, duke ndërmarrë një sërë masash të menjëhershme në seri kohore të ndryshme. Një fond prej 200 milionë lekësh u akordua me qëllim rikonstruksionin dhe rindërtimin e shtëpive të dëmtuara në qarqet Tiranë, Durrës dhe Lezhë; një fond prej 270 milionë lekësh u akordua me qëllim sigurimin e akomodimit të përkohshëm në hotele

nevoja për financim shtesë, e cila mbetet pas vitit 2023.

Duhet theksuar se një kosto të konsiderueshme financiare, të mbuluar tërësisht nga buxheti i shtetit, ka sjellë edhe politika e subvencionimit të qirasë për strehimin e familjeve të dëmtuara. Në vitin 2020, numri i familjeve përfituese nga politika e strehimit, pra e subvencionimit të qirasë, ishte rreth 14 100, ndërsa sot janë 8 400 familje që marrin bonusin e qirasë me një vlerë mesatare prej 20 mijë lekësh në muaj.

Përgjatë periudhës 2020-2022 janë 8,4 miliardë lekë, të cilat janë financuar për këtë qëllim dhe për vitin 2023 janë planifikuar 500 milionë lekë. Vazhdimi i këtij programi do të varet në mënyrë thelbësore nga ritmet e përfundimit të pjesës më të madhe të projekteve të nisura.

Nëse do të ndaleshim tek alokimet sipas viteve, për programin e rindërtimit janë përdorur: 540 milionë lekë nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit në vitin 2019; 16,7 miliardë lekë në vitin 2020; 29,7 miliardë lekë në vitin 2021 dhe 29,1 miliardë lekë në vitin 2022. Ndërsa, siç thashë edhe më parë, për vitin 2023 janë planifikuar 5 miliardë lekë. Ky fond do të përdoret i tëri për të financuar projektet në vazhdim dhe ata që kanë një ecuri më të mirë. Ajo që mund të them, dhe që është shumë e rëndësishme, është se aktualisht ne nuk kemi asnjë faturë të papaguar për projektin, nuk kemi detyrime të prapambetura të krijuara nga procesit i rindërtimit.

Më lejoni të qartësoj se fondet e rindërtimit janë kaluar me ligj të veçantë dhe rrjedhimisht, procesi i buxhetimit të projekteve, që lidhet me to, ka qenë i ndryshëm nga procesi i buxhetimit të të gjithë projekteve të tjera të investimit që madhe. Unë ju ftoj që, kur bëni këto supozime, të sillni shifra për projektet konkrete, me sipërfaqe konkrete dhe jo me supozime të dëgjuara nëpër ambiente të ndryshme apo kafene, apo nuk e di se ku i dëgjoni. Unë kam fakte të cilat tregojnë se nuk është kështu. Ndaj do të doja të dëgjoja faktet tuaja.

Programi ynë i rindërtimit ka në thelbin e tij një dimension të qenësishëm social, ku përfituesit kanë qenë: 38500 përfitues nga nënprogrami "Grante rikonstruksioni"; 1800 përfitues nga nënprogrami "Grante rindërtimi". Këto janë nga grantet për rikonstruksionin. Ndërkohë, sa i takon angazhimit përmes buxhetit të shtetit, për ndërtimin e objekteve të reja: nga nënprogrami i rindërtimit të banesave individuale nga njësitë zbatuese, por edhe donatorët, është financuar rindërtimi i 2552 banesave individuale; nga nënprogrami i rindërtimit të banesave kolektive është financuar rindërtimi i 299 banesave kolektive; janë financuar 216 banesa kolektive dhe 12 banesa individuale; janë rikonstruktuar 2001 banesa kolektive. Sa i takon infrastrukturës publike kanë përfunduar 9 kantiere në zonat e reja për zhvillim; janë 182 objekte arsimore të përfshira në programin e rindërtimit dhe 34

Tabela nr.9: Fondet e alokuara/ Vlerësimi dëmë+humbje sipas PDNA për Bashkinë Tiranë


Sektorët e dëmtuar nga tërmeti 2019	Viti 2020 Fondet e alokuara	Viti 2021 Fondet e alokuara	Totali I fondeve alokuar (2020/2021)	Sipas PDNA (dëme+humbje)	Raporti fonde alokuar total/ vl. PDNA(%)
Shëndeti			-	262,217,910	0%
Arsimi	1,326,264,955	4,895,586,338	6,221,851,293	5,670,308,420	110%
Banesa	1,264,902,747	1,749,419,480	3,014,322,227	26,385,523,310	11%
Prodhimtaria			-	2,697,274,370	0%

Infrastruktura	1,636,002,934	3,545,749,365	5,181,752,299	1,915,544,920	271%
Mbrojtja sociale	1,089,025,000	1,572,680,322	2,661,705,322	7,386,420	360%
Mbrojtja Civile	556,085,750	1,022,321,507	1,578,407,257	418,563,800	377%
Shpronesime	47,368,594	54,090,463	101,459,057	-	
Totali	5,919,649,980	12,839,847,475	18,759,497,455	37,356,819,150	50.22%

Burimi: PDNA, Bashkia Tiranë, Përpunoi: Grupi i auditimit

Grafiku nr. 7 Raporti mes fondeve të alokuara për periudhën 2020-2021 dhe vlerësimit të dëmeve dhe humbjeve sipas PDNA, për Bashkinë Tiranë.





Burimi: Bashkia Durrës, PDNA, Përpunoi: Grupi i auditimit

Fondet e alokuara për Bashkinë Durrës kanë qënë vetëm për sektorin e banesave në vlerën totale 2,241,063,397 lekë për gjithë periudhën 2020-2021, kundrejt vlerës 38,186,560,330 lekë që është vlerësimi sipas PDNA.Në total fondet e alokuara për Bashkinë Durrës përfaqësojnë rreth 5.9 % të vlerës së dëmit dhe humbjeve sipas PDNA për këtë Bashki.

Subvencionimi i pagesës së qirasë

Në lidhje me subvencionimin e qirave nga ana e NJQV grupi i auditimit mori kampion Bashkinë Durrës dhe analizoi praktikën e ndjekur nga ky subjekt lidhur me listën e përfituesve.

Referuar neni 2, Aktit Normativ Nr. 8 datë 07.12.2019 Për përdorimin e Procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019, NJVQV ngarkohen:

- Të hartojnë listat e familjeve banesat e të cilave janë shembur ose jane klasifikuar si të pabanueshme me akt konstatimi nga Instituti i Ndërtimit.
- Të vlerësojnë nivelin mesatar të qirasë për struktura të ndryshme apartamentesh, brenda 5 ditëve pune nga hyrja në fuqi e aktit normativ.

Nga shqyrtimi i evidencës së grumbulluar rezultoi se numri i familjeve që kanë aplikuar dhe janë miratuar paraprakisht me VKB për të përfituar nga subvencionimi i qirasë është 6,192, ndërsa numri i familjeve përfituese të bonusit të qirasë është 5,270 familje. Diferenca 922 familje rezulton e skualifikuar. Sipas Bashkisë Durrës arsyet e moskualifikimit të familjeve kanë qenë: "*Pas verifikimit të objekteve nga grupet e akt konstatimit të cilët kanë rezultuar të banueshëm, këtyre banorëve nuk i është bërë likuidimi i bonusit të qirasë.*" Nga analiza që grupi i auditimit i bëri listës së familjeve që kanë aplikuar për të përfituar subvencionimin e qirasë por nuk janë shpallur fitues rezultoi:

- 120 familje që kanë statusin e banesës me akt konstatim i pabanueshëm.
- 68 familje për të cilat rezulton statusi i pa inspektuar.

Gjithashtu grupi i auditimit mori si kampionë me përzgjedhje rastësore 4 aplikime nga 922 familjet e skualifikuara për përfitimin e bonusit të qirasë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të tyre rezultoi:

- Aplikanti E.K., statusi i banesës: i pabanueshëm, plotëson dokumentacionin për të përfituar bonus, arsyeja e mospërfitimit nuk ka depozituar dokumentin për llogarinë bankare.

19.Referuar nenit 2 të Aktit Normativ Nr. 8 datë 07.12.2019 'Për përdorimin e Procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019", Bashkia Durrës nuk ka kryer testimin e tregut për të përcaktuar nivelin mesatar të qirasë. Në relacionin shoqërues për VKB mungon dokumentacioni që argumenton testimin e tregut për të përcaktuar nivelin e qirasë sipas strukturave të banimit.

Konkluzion

17. Mungesa e testimit të tregut për përcaktimin e nivelit mesatar të qirave të banesave krijon mundësi për përdorimin jo eficient të fondeve të procesit të rindërtimit.

Rekomandim

19.1. Bashkia Durrës të marrë masa për testimin e tregut me qëllim përcaktimin e vlerave reale të qirave të banesave, dhe të propozojë ndryshimin e tyre (nëse do të jetë i tillë), për miratim në Këshillin Bashkiak.

Deri në prill 2022

Gjetje

20.Në Bashkinë Durrësjanë skualifikuar 922 familje të cilat kanë aplikuar për të përfituar bonusin e strehimit nga programi i subvencionimit të qirasë. Arsyet e skualifikimit për këto 922 familje, janë mungesa e të dhënave(numri i llogarisë bankare, vërtetim vendbanimi, etj) në dosjet përkatëse të aplikimit.Bashkia Durrës nuk ka kryer njoftime (të dokumentuara) për aplikantët që rezultojnë me mungesa të tilla në dokumentacion. Ndërkohë për 68 nga 922 familje, Bashkia Durrës nuk ka kryer ende inspektime për të verifikuar shkallën e dëmtimit të këtyre banesave.

Konkluzion

18. Procesi i identifikimit të dëmtimeve dhe inspektimeve në terren edhe pse ka qënë i vështirë duhet të kishte përfunduar nga ana e Bashkisë Durrës. Qëllimi i procedurës së përshpejtuar që përcakton Aktit Normativ Nr. 8, datë 07.12.2019 Për përdorimin e Procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019, është ardhja në ndihmë familjeve që ju janë dëmtuar banesat nga tërmeti dhe janë në kushte të pabanueshme.

Rekomandim

20.1. Bashkia Durrës të marrë masa të menjëhershme për të siguruar inspektimet në terren për 68 familjet që rezultojnë me statusin i painspektuar dhe që kanë aplikuar për të përfituar nga subvencionimi i qirasë.

Menjëherë

20.2Bashkia Durrës t'i japë prioritet shqyrtimit të listës së familjeve që kanë aplikuar për të përfituar nga subvencionimi i qirasë,të cilat rezultojnë me status banese "i pa banueshëm", dhe të

deri në 1 vit. Faza e rindërtimit e cila ka të bëjë me ndërtimin e banesave të përhershme, zhvillimin dhe rimëkëmbjen e sektorëve ekonomik, rindërtimit e objekteve social, kulturore shëndetësore etj., shkon deri në 5 vjet.

Transparenca

Akti Normativ Nr. 9, datë 16/12/2019 "Për përballimin e pasojave të fatkrqësisë natyrore", Neni 10, Parimi i informimit dhe transparencës *citon*: Autoritetet publike bëjnë publike çdo të ardhur, donacion apo shpenzim që kryhet me qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore". Gjithashtu neni 38 pika 2 shkronja b, e Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019, përcakton përmbajtjen e portalit unik qeveritar i cili duhet të përmbajë dhe jo vetëm:

- *të dhëna mbi fondin e rindërtimit*
- *burimin e krijimit të tij*
- *kontributet në para dhe kontributet në natyrë*
- *mënyrën e shpenzimit të këtij fondi*

Nga shqyrtimi i portalit unik qeveritar https://rindertimi.gov.al/. konstatohen mungesa si më poshtë:
Mungojnë të dhënat mbi fondin e rindërtimit për periudhën 2020, 2021 me ndryshimet përkatëse;
Mungojnë të dhënat mbi burimin e krijimit të fondit të rindërtimit;
Mungojnë të dhëna mbi kontributet në para dhe kontributet në natyrë;
Mungojnë të dhëna që tregojnë mënyrën e shpenzimit të fondit të rindërtimit në mënyrë akumulative dhe të qartë për publikun.

Në lidhje me sa më sipër nga ana e grupit të auditimit u mbajt Akt Konstatim protokolluar në MSHR me nr. 3501/1 prot. datë 08.09.2021. Një tjetër çështje që u evidentua lidhur me portalin unik qeveritar ose portalin e transparencës siç njihet ndryshe ishte edhe se Minisri i Shtetit për Rindërtimin nuk ka përcaktuar nëpërmjet një akti nënligjor (Urdhër apo Udhëzim) personin përgjegjës për administrimin e portalit unik qeveritar.

Nga shqyrtimi i faqes zyrtare të Bashkisë Tiranë https://www.tirana.al, dhe Bashkisë Durrës https://www.durres.gov.al, si edhe nga përgjigjet e pyetësorëve të fazës së terrenit analizuar nga këto subjekte rezulton mungesë totale informacioni që lidhet me procesin e rindërtimit. Sipas subjektit "*Faqja zyrtare e Bashkisë Tiranë, nuk ka të dhëna për arsye të mbingarkesës së stafit gjatë periudhës së tërmetit, dhe pakësimit të stafit gjatë periudhës së pandemisë", çka nuk justifikon mungesën e transparencës me publikun.*

Gjetje

7. Programi i përgjithshëm i rindërtimit nuk është hartuar nga Komisioni Shtetëror i Rindërtimit në reference të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", neni 13 gërma "b" pika "ii", dhe VKM nr. 878 datë 24.12.2019 "Për përbërjen, organizimin, veprimtarinë dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit", Kreu 3, pika 1, gërma "a".
8. Krahas mungesës së këtij Programi nuk ekziston asnjë dokument tjetër politik zyrtar i cili të përcaktojë qartë afate kohore se kur do të përfundojë i gjithë procesi i rindërtimit. Këto afate,

Përgjatë periudhës 2020-2022 janë 8,4 miliardë lekë, të cilat janë financuar për këtë qëllim dhe për vitin 2023 janë planifikuar 500 milionë lekë. Vazhdimi i këtij programi do të varet në mënyrë thelbësore nga ritmet e përfundimit të pjesës më të madhe të projekteve të nisura.

Nëse do të ndaleshim tek alokimet sipas viteve, për programin e rindërtimit janë përdorur: 540 milionë lekë nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit në vitin 2019; 16,7 miliardë lekë në vitin 2020; 29,7 miliardë lekë në vitin 2021 dhe 29,1 miliardë lekë në vitin 2022. Ndërsa, siç thashë edhe më parë, për vitin 2023 janë planifikuar 5 miliardë lekë. Ky fond do të përdoret i tëri për të financuar projektet në vazhdim dhe ata që kanë një ecuri më të mirë. Ajo që mund të them, dhe që është shumë e rëndësishme, është se aktualisht ne nuk kemi asnjë faturë të papaguar për projektin, nuk kemi detyrime të prapambetura të krijuara nga procesit i rindërtimit.

Më lejoni të qartësoj se fondet e rindërtimit janë kaluar me ligj të veçantë dhe rrjedhimisht, procesi i buxhetimit të projekteve, që lidhet me to, ka qenë i ndryshëm nga procesi i buxhetimit të të gjithë projekteve të tjera të investimit që parashikon ligji për menaxhimin buxhetor. Projektet e investimit nuk kanë qenë pjesë e projektbuxhetit afatmesëm.

A ishte e mundur që në vitet 2019 dhe 2020 ne të kishim një parashikim të saktë për fondet dhe projektet që do të nisnin, kur vlerësimet ende nuk ishin përfunduar dhe ishin në proces? Arsyeja pse ne krijuam këtë fleksibilitet në procedurat buxhetore ishte nevoja dhe urgjenca që kishim për të filluar proceset e investimeve. Ne nuk mund të parashikonim sa do të ishte kostoja totale e çdo godine apo e çdo projekti.

U tha këtu dhe u përsërit se fondet e rindërtimit janë tenderuar. Sigurisht që janë tenderuar. Të gjitha fondet e rindërtimit janë tenderuar, si çdo projekt tjetër që tenderohet në Shqipëri dhe jashtë saj. A ka procedura pa tender? Nuk mund të ketë procedura pa tender. Të gjitha janë tenderuar dhe janë subjekte të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe enteve që janë përgjegjëse për të kontrolluar ato fonde.

Gjithashtu, u tha këtu se projektet e tenderuara të rindërtimit janë 3 apo 4 herë më të shtrenjta se ato që janë financuar nga donatorët e huaj apo BE-ja. Kjo është një tjetër gënjeshtër e madhe. Unë ju thoj që, kur bëni këto supozime, të sillni shifra për projektet konkrete, me sipërfaqe konkrete dhe jo me supozime të dëgjuara nëpër ambiente të ndryshme apo kafene, apo nuk e di se ku i dëgjoni. Unë kam fakte të cilat tregojnë se nuk është kështu. Ndaj do të doja të dëgjoja faktet tuaja.

Programi ynë i rindërtimit ka në thelbin e tij një dimension të qenësishëm social, ku përfituesit kanë qenë: 38500 përfitues nga nënprogrami "Grante rikonstruksioni"; 1800 përfitues nga nënprogrami "Grante rindërtimi". Këto janë nga grantet për rikonstruksionin. Ndërkohë, sa i takon angazhimit përmes buxhetit të shtetit, për ndërtimin e objekteve të reja: nga nënprogrami i rindërtimit të banesave individuale nga njësitë zbatuese, por edhe donatorët, është financuar rindërtimi i 2552 banesave individuale; nga nënprogrami i rindërtimit të banesave kolektive është financuar rindërtimi i 299 banesave kolektive; janë financuar 216 banesa kolektive dhe 12 banesa individuale; janë rikonstruktuar 2001 banesa kolektive. Sa i takon infrastrukturës publike kanë përfunduar 9 kantiere në zonat e reja për zhvillim; janë 182 objekte arsimore të përfshira në programin e rindërtimit dhe 34 institucione dhe vepra publike të financuara nga fondi i rindërtimit.

Me qëllim realizimin me sa më pak kosto të këtij projekti, ne ndërmorëm një tjetër nismë, atë të përjashtimit të TVSH-së nga i gjithë procesi i rindërtimit dhe të gjitha furnizimeve të lidhura me rindërtimin. Pra, produkti për rindërtimin, i porositur nga entet shtetërore apo strukturat e pushtetit lokal, është përjashtuar nga 20 %-shi i TVSH-së, çka nënkupton uljen e kostove të ndërtimit.

Askush nuk u la vetëm, ne zgjodhëm të mbështesnim këdo dhe t'iu gjendeshim pranë qytetarëve dhe sipërmarrjes. Fatura financiare që duhet të paguanim, ishte e lartë. Janë rreth 75,5 miliardë lekë të shpenzuara deri në fund të vitit 2022, vetëm nga buxheti i shtetit. Kjo shumë u financua si nga shkurtimi i shpenzimeve dhe investimeve të tjera, po ashtu edhe nga huamarrja.

Dua të ndalem pak te huamarrja, sepse dëgjova pak më parë që u parashtrua se ne kemi marrë eurobond për të financuar rindërtimin dhe se nuk kemi përfituar nga kreditë e vëna në dispozicion në Konferencën e Donatorëve, pasi

milionë lekë, nga të cilat 27.2 milionë lekë nga të ardhurat e veta të njësive të qeverisjes vendore dhe 9.3 milionë lekë nga të ardhurat e veta të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Raportimi në realizim i këtyre fondeve si pjesë përbërëse e fondit të rindërtimit është realizuar nëpërmjet rritjes së autorizuar me të ardhurat e veta, ndërkohë që procesi i rindërtimit është parashikuar të realizohet me financim nga buxheti qendror, duke dështmuar për mungesën e financimit të nevojave në kohën e duhur dhe me fondet e duhura nga qeverisja qendrore.
Rezulton se për projektet e rindërtimit është përdorur i njëjti kod projekti/produkti për disa investime të ndryshme, duke mos identifikuar specifikisht investimet e kryera për çdo projekt/produkt, ku për projektet e rindërtimit të financuara nga qeverisja qendrore janë përdorur në total 9 kode projektesh. Kjo sjell vështirësi në ndjekjen, monitorimin dhe auditimin e ecurisë të secilit prej tyre.
Konstatohet se në ligjin nr. 97/2023 *"Për buxhetin e vitit 2024"*, fondet për rindërtimin janë planifikuar në shumën 9,000 milionë lekë për vitin 2024, ndërsa në tabelën 4 *"Treguesit Fiskalë të konsoliduar"*, bashkëlidhur po këtij ligji, vlera e planifikuar për fondin e rindërtimit për vitet 2025 është 2,000 milionë lekë dhe për vitin 2026 është 0 lekë. Pra, rezulton se kosto totale e projekteve të deritanishme të miratuar me VKM, nuk është shoqëruar/mbuluar me ndryshim dhe paraqitje të drejtë të vlerës së planifikuar me ligjin e buxhetin për fondet e rindërtimit në vitet buxhetore vijuese. Referuar të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Buxhetit konstatohet se kosto totale e fondeve të shpërndara sipas VKM-ve të miratuara nga 2020-2024 paraqitet në shumën 122,794 milion lekë, ndërkohë që realizimi faktik për të njëjtën periudhë paraqitet në shumën 100,030 milion lekë, duke rezultuar në një diferencë në shumën 22,764 milion lekë si në tabelën e mëposhtme:

Në milion lekë

	Kosto projekti	**Fakt (2020)**	**Fakt (2021)**	**Fakt (2022)**	**Fakt (2023)**	**Fakt (2024)**	**Fakt total (2020-2024)**	**Mbetur për financim**
Qendrori	35,119	7,255	11,628	8,208	3,701	555	31,347	3,772
Vendori	87,675	9,447	18,120	20,905	12,483	7,728	68,683	18,992
Total Vendor + Qendror	**122,794**	**16,703**	**29,748**	**29,112**	**16,184**	**8,283**	**100,030**	**22,764**

Diferenca e konstatuar prej 22,764 milion lekësh tregon një mungesë të financimit të nevojshëm për fondin e rindërtimit, e cila nuk është pasqyruar në tabelat shoqëruese të ligjit të buxhetit për vitet e ardhshme buxhetore. Kjo evidenton një mospërputhje midis planifikimit buxhetor dhe nevojave reale të projekteve të rindërtimit, duke mbartur riskun për realizimin e tyre në përputhje me financimin e parashikuar ligjor, referuar angazhimeve të ndërmara në periudhat e mëparshme.

Në vijim të mos planifikimit të fondeve të nevojshme në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar në buxhetin e vitit 2024 dhe për vitet në vijim konstatohet se nuk janë respektuar përcaktimet e bëra në ligjin 97/2023 *"Për buxhetin e vitit 2024"*, përsa i përket nenit 7 ku citohet *"Fondi i rindërtimit për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019 prej 9,000 milionë lekësh përdoret për të përballuar kostot për projektet e miratuara dhe të pa financuara të viteve të mëparshme dhe pjesa e mbetur për projekte të reja."*, pasi gjatë vitit 2024 jo vetëm që nuk janë financuar të plota projektet në vazhdim nga vitet e kaluara, por miratuar VKM të

B.4.5 Fondi i rindërtimit

Shpenzimet e fondit të rindërtimit për vitin 2025 janë realizuar në shumën 3,157 milionë lekë, ose 63.1% të planit përfundimtar, duke rezultuar 1,843 milionë lekë (36.9%) nën nivelin e parashikuar dhe 5,114 milionë lekë më pak krahasuar me vitin 2024. Pavarësisht këtij niveli realizimi, plani i fondit të rindërtimit ka mbetur i pandryshuar gjatë vitit, nga miratimi i buxhetit fillestar deri në miratimin e aktit normativ nr. 11/2025.

Të mijëra lekë

Emertimi	Fakti 2024	Projekt-buxheti	Ligji fillestar	AN 3	AN 6	AN 10	AN 11	Fakti 2025	Diferenca fakt-plan
Fondi i Rindërtimit	8,271	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	3,157	-1,843

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH

Shpërndarja dhe realizimi i fondeve: Gjatë vitit 2025, fondi i rindërtimit me kod "94920AA" është çelur në shumën 5,000 milionë lekë. Nëpërmjet 18 vendimeve të Këshillit të Ministrave janë shpërndarë 1,733.5 milionë lekë, ose 34.7% e fondit të çelur, nga të cilat 1,544 milionë lekë për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe 189.5 milionë lekë për njësitë e qeverisjes qendrore. Në përfundim të vitit kanë mbetur të pashpërndara 3,266.5 milionë lekë.

Nga auditimi është konstatuar se të 18 vendimet janë miratuar gjatë muajit dhjetor 2025. Prej tyre, shtatë vendime, me vlerë të përgjithshme 763.37 milionë lekë, janë miratuar më 30.12.2025. Kjo shumë përfaqëson rreth 44% të fondeve të shpërndara gjatë vitit dhe 15.3% të fondit të çelur, duke lënë një periudhë shumë të kufizuar për realizimin e shpenzimeve brenda vitit buxhetor.

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 7 të ligjit nr. 115/2024, nuk i është dhënë përparësi financimit të projekteve të miratuara në vitet e mëparshme, duke miratuar projekte të reja.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, përveç fondeve prej 1,544 milionë lekë të alokuara gjatë vitit 2025, kanë pasur në dispozicion edhe 7,311 milionë lekë të trashëguara nga vitet e mëparshme, duke arritur në një total prej 8,855 milionë lekë. Realizimi për këto njësi ka rezultuar 3,131 milionë lekë, ose rreth 35.4% e fondeve në dispozicion. Për njësitë e qeverisjes qendrore, kundrejt fondeve të alokuara prej 189.5 milionë lekë, janë realizuar 26 milionë lekë, ose rreth 13.7%. Realizimi sipas burimit të fondeve paraqitet në tabelën e mëposhtme.

KLSH

Të mijëra lekë

Burimi	Disponibël 2025	Fakti 2025
Fonde të alokuara nëpërmjet VKM në vitin 2025, nga këto:	1,734	1,031
Njësi të qeverisjes vendore	*1,544*	*1,005*
Njësi të qeverisjes qendrore	*190*	*26*
Fonde të trashëguara nga vitet e mëparshme, nga këto:	7,311	2,126
Njësi të qeverisjes vendore	*7,311*	*2,126*
Total	9,045	3,157

Burimi: Ministria e Financave, përpunuar nga KLSH

Realizimi prej 3,157 milionë lekë përfaqëson 63.1% të planit vjetor prej 5,000 milionë lekë, por vetëm rreth 34.9% të fondeve të alokuara dhe të trashëguara në dispozicion. Niveli i ulët i realizimit është evidentuar edhe në analizën sipas bashkive, ku, sipas të dhënave të auditimit, ai varion nga 12% në Bashkinë Lezhë deri në 57% në Bashkinë Vorë. Shpërndarja e fondeve në fundvit, së bashku me mbartjen e fondeve të pashfrytëzuara, evidenton dobësi në lidhjen ndërmjet planifikimit, alokimit dhe ecurisë faktike të projekteve, duke rritur riskun e shtyrjes së afateve të përfundimit.

3. Fondi i rindërtimit

Fondi i rindërtimit vijon të përbëjë një burim të rëndësishëm financimi për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Për 8 mujorin 2026, buxheti i disponueshëm për këtë fond rezulton në **6.6 miliard lekë**, ndërsa realizimi faktik ka arritur në **977 milion lekë**, ose rreth **14.8%** të fondit të programuar.

Nga realizimi total, 285 milion lekë janë përdorur për shpenzime kapitale, 8 milion lekë për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, ndërsa 684 milion lekë janë përdorur në formën e transfertave për familjet dhe individët përfitues. Struktura e realizimit tregon se pjesa më e madhe e fondeve të përdorura deri në këtë periudhë është orientuar drejt mbështetjes së familjeve dhe individëve të prekur, ndërkohë që pjesa e investimeve pritet të intensifikohet gjatë pjesës së mbetur të vitit.

Njëkohësisht, vihet re se ritmi i realizimit të fondit mbetet relativisht i ulët krahasuar me fondin e disponueshëm, megjithatë ekziston potenciali për përshpejtim të zbatimit të projekteve të rindërtimit gjatë muajve në vijim rritje të realizimit të shpenzimeve nga ky fond.

Tabela 26: **Detajimi i fondit të rindërtimit sipas llojit të shpenzimeve** ***(në milion lekë)***

Nr	EMËRTIMI	8 mujori 2026	
		Buxheti operativ	Realizimi faktik
III.	**Fondi i Rindërtimit**	**6,617**	**977**
	Shpenzime kapitale	2,693	285
	Shpenzime Opereative & Mirëmbajtje	470	8
	Transferta për familjet dhe individët	3,454	684

Burimi: Ministria e Financave, SIFQ, https://financa.gov.al/realizimi-accrual_cash/